



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Buletini i Njoftimeve Publike

Nr.185 Datë 20.12.2021

Agjencia e Prokurimit Publik

Blv "Dëshmorët e Kombit"

Tel: + 355 4 2277510

e-mail: info.app@app.gov.al

<https://www.app.gov.al>



Dokumentat të jenë me zarf të mbyllur i cili do të protokollohet, dhe dorëzohet pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore deri në datën 30.12.2021.

UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ” GJIROKASTËR

Njoftim për vend të lirë pune

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 57 dhe 59; Statutit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, nenet 36, 47, 56, shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune si personel akademik i kategorisë “Lektorë”/“Asistent-lektorë”, në angazhim me kohë të plotë dhe kontratë me kohëzgjatje të caktuar, pranë Njesisë Bazë të Gjuhëve të Huaja.

KRITERET KRYESORE TË PUNËSIMIT

1. Të kenë përfunduar studimet e larta, Bachelor dhe Master i Shkencave, për gjuhën angleze, brenda ose jashtë vendit, në sistemin me kohë të plotë;
2. Të kenë notë mesatare të përgjithshme të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) në gjuhën angleze dhe të ciklit të dytë Master i Shkencave në gjuhën angleze, jo më pak se 8 (tetë);
3. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në arsimin universitar;
4. Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
5. Të ketë aktivitet botues në revista shkencore të njohura zyrtarisht, si dhe prezantime shkencore në konferenca kombëtare e ndërkombëtare;
6. Kanë përparësi kandidatët që:
 - a. Kanë fituar gradën shkencore PhD ose “Doktor” në fushën e gjuhës angleze;
 - b. Krahas gjuhës angleze zotërojnë dhe një gjuhë tjetër të Bashkimit Evropian (frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT QË KONKUROJNË:

1. Kërkesë me shkrim;
2. Jetëshkrim sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
4. Kopje të diplomës/diplomave të studimeve universitare dhe të listës/listave të notave përkatëse (të noterizuara). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të dorëzohet njëhësisht nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (Raport mjekësor për aftësitë në punë);

7. Vërtetim i gjëndjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
8. Dokumentacion nga Institucioni ku ka punuar që nuk ka marrë masë disiplinore të largimit nga puna;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera që pasqyrohen në jetëshkrimin e kandidatit;
10. Dëshmi penaliteti

Dokumentat e mësipërm të jenë të noterizuara dhe dorëzohen pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike - Administrative në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, të shoqëruara me inventar. Mosparaqitja e plotë e dokumentave, sjell s'kualifikim të kandidatit. Përzgjedhja e kandidatit/kandidatëve fitues bëhet përmes konkurimit me dosje. Konkursi zhvillohet pranë Rektoratit të Universitetit "Eqrem Çabej".

Afati i fundit i pritjes së aplikimeve është brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit.